

## **AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“ABA&Partners” sh.p.k.**

## AKT THEMELIMI DHE STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ABA&Partners” sh.p.k.

Sot në datën 14.03.2022 bazuar në ligjin Nr. 9901 “Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar dhe ne ligj Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, themeluesi:

Ervin Koçi, i biri i Agim i datëlindjes 05.04.1975, me numër personal të kartës së identitetit H50405086P lindur në Fier, e banues në Tiranë, me adresë Rruga: “Ndreko Rino”, Nd. Pall. 24; Hyrja. 1; Ap. 31, Njësia Administrative Nr. 5, Tiranë me zotësi të plotë juridike për të vepruar vendosi të krijojë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, redaktoi dhe nënshkroi Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “ABA&Partners” sh.p.k. më poshtë vijon:

### Kreu I

### THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

#### Neni 1

#### Emri, Data e Themelimit dhe Themeluesit

1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ABA&Partners” sh.p.k. (më poshtë e quajtur “Shoqëria”) e cila është themeluar më datën 14.03.2022. “ABA” është shkurtim i fjalëve i “Albanian Business Adviser”.

1.2 Shoqëria “ABA&Partners” sh.p.k. themelohet nga ortaku i vetëm Ervin Koçi me këto të dhëna:

- Ervin Koçi, i biri i Agimit i datëlindjes 05.04.1975, me numër personal të kartës së identitetit H50405086P lindur në Fier, e banues në Rruga “Ndreko Rino”, Nd. Pall. 24; H.1; Ap.31, Njesia Administrative Nr. 5, Tiranë, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Adresa Zyrtare e-mail i shoqërisë do të jetë adresa: [info@abapartners.al](mailto:info@abapartners.al)
- Numri i Kontaktit të Shoqërisë do të jetë: +355 68 20 46 002

**Neni 2  
Objekti**

I. Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktivitetave që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:

1. Kryerjen e shërbimeve dhe konsulencës kontabële, fiskale, administrative si dhe përfaqësimin fiskal në nivel kombëtar e ndërkombëtar të shoqërive.
2. Ofrimin e shërbimeve për optimizmin dhe zhvillimin e aktivitetave të shoqërive, shoqërive profesionale dhe profesionalistëve individualë si dhe hartimin e planeve të biznesit dhe fizibilitetin e projekteve në fusha të ndryshme.
3. Përpunimin e të dhënave për bizneset dhe organizatat, edhe duke përdorur burimet njerëzore të tretëve.
4. Konsulencë dhe asistencë lidhur me drejtimin dhe organizimin për sa i përket marketingut, prodhimit, tregtimit, administrimin kontabël dhe të financave, me funksionet e qeverisjes korporative, çështjet e korporatave, planifikimin fiskal, organizimin e sistemeve si dhe ato të informatikës së aplikuar, puna kërkimore, përzgjedhja dhe trajnimi i personelit.
5. Ofrimin e ndihmës, këshillave, koordinimit dhe kontrollit për investime të mundshme në Shqipëri dhe jashtë vendit, në emër të klientëve, hulumtimi i partnerëve financiare, industrial ose tregtar në emër të klientëve.
6. Kryerjen e operacioneve të blerjeve, rishitjes dhe administrimit të aktivitetave tregtare, industriale, shoqëritë bujqësore dhe veprime publike të lidhura me to.
7. Ofrimin e aktivitetit të mbledhjes së borxheve, konsulencë biznesi për administrimin e huave të këqija, dhe për shtyrjen e debitorëve për të paguar.
8. Blerjen, shitjen dhe administrimin e aksioneve, bono, të letrave me vlerë të borxhit publik dhe privat në përgjithësi, të aksioneve në shoqëri, letra me vlerë, pasurive financiare, industriale, tregtare dhe pasurive të paluajtshme.
9. Përbushjen e të gjitha operacioneve tregtare, në fushën e pasurive të paluajtshme, financiare dhe industriale që do të konsiderohen të nevojshme nga organi administrativ ose të dobishme për të arritur qëllimin e shoqërisë.
10. Kryerjen e transaksioneve financiare dhe të pasurive të paluajtshme që do të konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për arritjen e qëllimit të shoqërisë, të marrë pjesë në shoqëri të tjera me objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me aktivitetin e vet kryesor, si dhe të japë garanci për hua si dhe garanci hipotekare në favor të ortakeve dhe në favor të tretëve.
11. Kryerjen e aktivitetit të ndërmjetësimit, vlerësimit, shitblerjes dhe qirasë të pasurisë së paluajtshme kërkimeve dhe studimeve të tregut në fushën imobiliare, tregtare etj.

12. Ndërmjetësim dhe administrim të kontratave leasing, franchising, përsa lejohen nga ligji
  13. Administrim të shoqërive tregtare dhe përfaqësim juridik i te tretëve brenda dhe jashtë vendit.
  14. Pjesëmarrja për vete, për të tretë në prokurime publike, gara, ankande, koncensione etj.
  15. Organizim panairesh, seminare, konferanca brenda dhe jashtë vendit.
  16. Shoqëria mund të ketë pjesëmarrje dhe interesa në shoqëri apo ndërmarrje të tjera, të cilat kanë objekt të ngjashëm, të përafërt ose të lidhur me objektin e shoqërisë, te cilat konsiderohen të nevojshme ose të dobishme për përbushjen e objektit të shoqërisë.
  17. Shoqëria mund të bashkohet dhe të marrë pjesë edhe vullnetarisht në konsorciume, si dhe të marrë pjesë në sipërmarrjet e përbashkëta për iniciativa të caktuara të biznesit ose industrisë.
  18. Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqata, konsorciume dhe organizata që kanë tendencë për të lehtësuar dhënien e kredive me kushte të favorshme ose grandeve
- II. Për të realizuar objektin e aktivitetit të saj, Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përbushë ose të jetë i dobishëm për përbushjen e objektit të saj.

**Neni 3  
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku. Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar.

**Neni 4  
Selia**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: "Ruga Tish Daija, Kompleksi Kika 2, Godina 1C-8, Apartamenti 7D, Tiranë.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyll degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

## Kreu II

### KAPITALI

#### Neni 5

#### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themelues i Shoqërisë është 100 000 (njëqind mijë) lekë, e shprehur në 1 kuotë, të kontribuara nga ortaku në vlerën monetare 100 000 (njëqind mijë) lekë. Kapitali i Shoqërisë nënshkruhet menjëherë dhe do të paguhet nga ortaku i vetëm që zotëron 100% (njëqind përqind) të kontributeve në kapitalin e shoqërisë, përkatësisht nga:

*Z. Ervin Koçi, shtetas shqiptar, i lindur në Fier, i biri i Agim-it, i datëlindjes 05.04.1975, me numër personal të kartës së identitetit H50405086P e banues në Tiranë në Rrugën "Ndreko Rino", Nd. Pall. 24; H. 1; Ap. 31, Njesia Administrative Nr. 5, i cili zotëron 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.*

#### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogëlimi kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anët e kontributeve në natyrë nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendime në të njejtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a. Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b. Shit-blerjes;
- c. trashëgimisë;
- d. dhurimit;
- e. çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

##### Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshjet e mëposhtme:

- a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. ndryshimet e statutit;
- c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i. pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

**Neni 9**

**Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar përr mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk eshtë thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortaku(ët) janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**Neni 10**

**Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë përcëshje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**Neni 11**

**Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d. përcaktimin eshpërblimeve;
- e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecucisë se veprimtarisë;
- f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedime te tjera ndaj administratorëve;

g. miratimin e rregullave proçedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**Neni 12**  
**Përjashtimi nga e drejta e votës**

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13**  
**Administrimi**

- Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, eshtë 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje: Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita eshtë i pavlefshëm.
- Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator:  
*Z. Ervin Koçi e cila do të ushtrojë kompetencat për një periudhë 5- vjeçare duke filluar nga data e nënshkrimit të këtij akti.*

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorit**

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit, të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhë të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë

- së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet përshpérndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente për para asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrime dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g. raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçëm e me rëndësi të veçantë për veptimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratori është i detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- i. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- ii. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- iii. shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetevë të shoqërisë; që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi

### **Neni 15 Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera, gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas, neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare", administratori detyrohet:

- a. të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të ndikimit të

- veprimtarisë së shoqërisë në mjesht;
- b. të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktura në këto dispozita;
  - c. të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d. të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
  - e. të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
1. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim,që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse,veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
  2. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes,si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta .Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
  3. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
    - a. U kthen ortakëve kontributet;
    - b. U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
    - c. U shpërndan aktivet shoqërisë
    - d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
    - e. Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**Neni 16****Vula**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

**Kreu IV**  
**VITI FINANCIAR DHE EKSPERTËT**

**Neni 17**  
**Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

**Neni 18**  
**Kontrolli Financiar**

Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emërojë një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.

**Neni 19**  
**Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**Neni 20**  
**Bilanci vjetor**

Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

**Neni 21**  
**Dividenti**

Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare",

Shoqëria, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në perputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

## Kreu V

### PRISHJA- RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

#### Neni 22

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b. Me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d. Nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar;
- e. Më vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortaku(ët) merr vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaku(ët).

Nëse Ortaku(ët) nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 23

##### Riorganizimi i shoqërisë: bashkimi dhe ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakut(ëve), në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### Neni 24

##### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e

legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 25**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Akt themelimi dhe statuti i shoqërisë u përpilua në katër kopje, për t'jua shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbeten në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ABA&Partners” sh.p.k.

ORTAKU I VETËM  
Ervin Koçi  
Kosci